



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit të Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar		17/09/2021	
Nj. Org	Numër	S. i. i.	Vlera
01	060/01	96904	

Bashkësia Lokale e Baicës (Abri, Tërdec, Baicë, Krajkovë dhe Damanek) më datë. 19.08.2021 ora 15:10 në SHFMU “Migjeni” Baicë.



Mbledhjen e hapi Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, Bekim Dobra, duke filluar në ora 15:10, ku të pranishëm ishin: kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, Drejtori për Buxhet dhe Financa, Shyqiri Bublaku, Drejtori për Arsim, Muhamet Gjoka, Drejtori i Infrastrukturës Lokale, Endrit Gllareva, administratorë të vendbanimeve nga bashkësia e Baicës dhe përfaqësues të lagjeve.

Fillimisht, Bekim Dobra i përshëndeti të gjithë administratorët e fshatit dhe qytetarët e pranishëm në takim, dhe shpalosi detajet e këtij takimi. Dobra ka njoftuar të pranishmit për rendin e ditës dhe ka treguar rregullat e takimit. Të pranishmit janë pajisur me draft-listën e investimeve kapitale për vendbanimin e tyre dhe janë njoftuar për buxhetin e ndarë për vitet në vazhdim. Po ashtu ata, janë njoftuar se dokumenti që kanë para vetës, është vetëm draft, sepse i njëjti ndryshon pikërisht në këto dëgjime me marrjen e kërkesave të arsyeshme nga qytetarët deri sa të merret vendim në mbledhjen e Kuvendit të Komunës para datës 30 shtator.

Të pranishmit janë pajisur me draft-listën e investimeve kapitale për vendbanimin e tyre dhe janë njoftuar për buxhetin e ndarë për vitet në vazhdim. Po ashtu ata, janë njoftuar se dokumenti që kanë para vetës, është vetëm draft, sepse i njëjti ndryshon pikërisht në këto dëgjime me marrjen e kërkesave të arsyeshme nga qytetarët.

Rend dite:

1. Informatë e përgjithshme lidhur me buxhetin komunal 2022-2024.
2. Lista e investimeve kapitale në Bashkësinë e Baicës.
3. Kërkesat e banorëve.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci- ka përshëndetur takimin dhe ka treguar shkurtimisht për të arriturat deri më tani që i ka bërë komuna gjatë këtyre viteve dhe ka falënderuar të gjithë administratorët e vendbanimeve dhe përfaqësues të lagjeve për bashkëpunimin e treguar në realizimin e projekteve të përbashkëta për të mirën e qytetarëve.

Drejtori i Financave, Shyqiri Bublaku: Bublaku ka falënderuar të pranishmit që kanë gjetur kohën të jenë pjesë e këtyre dëgjimeve buxhetore dhe ka thënë se takimet e zhvendosura në lokalitete, kanë për qëllim që të hartojnë një buxhet sa më të mirë me projekte konkrete që dalin nga qytetarët të cilët marrin pjesë në këto takime. Bublaku ka thënë se këto dëgjime të mbajtura në muajin Gusht, kanë ardhur pas pranimin të Qarkorës së dytë buxhetore nga Ministria e Financave. Ai ka treguar para të pranishmeve edhe për mjetet buxhetore që ka planifikuar komuna t'i ndaj për vitet 2022-2024.

Kërkesat e qytetarëve;

Remzi Lestrani, banor i fshatit Baicë – ka përshëndetur takimin dhe ka falënderuar për punët e kryetar në fshatin Baicë. Ai ka shtuar se për vitin e ardhshëm, fshati ka nevojë të këtë të përfshira të gjitha lagjet me ndriçim elektrik dhe të asfaltohen rrugët e lagjeve që kanë mbetur.

Samedin Kiqina – administrator i fshatit Baicë – në fshatin tonë kemi nevojë për ndriçim të rrugëve që janë me të frekuentuara. Ai ka shtuar se janë disa lagje të cilat nuk kanë qasje fare në rrjetin e kanalizimit dhe është e nevojshme që në planifikimin për vitin e ardhshëm të kompletohet fshati me rrjetin e kanalizimit. Kiqina ka kërkuar që për vitin e ardhshëm të ndahen mjete buxhetore për mirëmbajtjen e varrezave si dhe rrethojnë e tyre. Po ashtu fshati jonë ka nevojë edhe për asfaltimin e disa rrugicave që nuk janë të përfunduar e po ashtu janë disa lagje që të paktën të shtrohen me zhavor.

Kryetari Lladrovci – kërkesat e juaja u morën parasysh dhe sipas mundësive buxhetore do të hyjnë në planifikim për vitin e ardhshëm. Ju jeni në dijeni, që me ardhjen time, fshati juaj vetëm rrugën kryesore e ka pasur të rregulluar, tani thuaje të gjitha lagjet e fshatit Baicë janë të asfaltuara, kanë mbetur vetëm disa rrugica me 80 deri në 100 metra e që edhe ato do të kryhen, po ashtu ju nuk keni pasur asnjë metër rrjet të kanalizimit, tani mbi 80 për qind e fshatit ka rrjetin e rregulluar të kanalizimit, prandaj, projektet kryhen sipas kërkesave tuaja dhe numrit të banorëve të lagjeve dhe nuk kanë mundur të kryhen të gjitha sepse mjetet buxhetore kanë munguar, por ju po e shini draft listën e investimeve kapitale dhe për vitin e ardhshëm janë planifikuar dhjetëra projekte dhe do të kryhen edhe kërkesat e juaja të fshatit.

Ramadan Ramaj – banorë i fshatit Tërdec – kam kërkuar edhe herën e kaluar në dëgjime buxhetore, për rrugën Tërdec-Vuçak dhe ka filluar pak të punohet, por kisha kërkuar që kjo rrugë të kryhet gjatë këtij viti, po ashtu fshati jonë ka nevojë të madhe për ujësjellës si dhe disa rrugica në lagje. Po ashtu kemi nevojë edhe për një fushë sportive, e disa lagje kanë mbetur pa e përfunduar rrjetin e kanalizimit. Në rrugën kryesore është mirë që për vitin e ardhshëm të rregullohet edhe kanalizimi.

Kryetari Lladrovci – lidhur për ujësjellës e kam sqaruar disa herë, por e ndjej për obligim që edhe këtu në këtë dëgjim buxhetor të sqaroj se pse në 22 vendbanime nuk ka ujë të pijshëm. Problemi për t'i furnizuar me ujë të pijshëm 22 fshatra, ish kryer qysh nga viti 2018, por siç e dini besoj, kur është bërë testimi i pompave në Kamenicë, gypat kryesor nuk ishin vendosur, projekt ky i realizuar në vitin 2013-2014 dhe për këtë çështje janë zhvilluar edhe hetime e për të mos u penguar hetimet, ishin stagnuar punimet. Tani janë vendosur gypat dhe projekti deri në Kamenicë është mirë, nëse nuk del telashe me gypat e vendosur në fshatra, projekti besoj që deri në gjysmën e dytë të vitit të ardhshëm do të kryhet ky projekt mjaft i rëndësishëm dhe 22 fshatra do të kenë ujë të pijshëm.

Xhevet Demaku- administrator i fshatit Abri – për vitin e ardhshëm, prioritet i fshatit tonë është bazeni i ujësjellësit, sepse shumica e vendbanimeve nuk kanë rrjet të ujësjellësit dhe nuk kanë furnizim, prandaj prioritet kryesor i joni mbetet rregullimi i ujësjellësit. Ka lagje që gjatë verës nuk kanë fare ujë të pijshëm. Po ashtu kemi nevojë edhe për rregullimin e trotuarit në disa rrugë ku kalojnë nxënësit për në shkollë.

Kryetari Lladrovci – për projektin e ujësjellësit, vlen atë që i thash para folësit, por prap po ju tregoj edhe juve, se problemi me ujësjellës nuk është për fajin tim, megjithatë jemi duke bërë përpjekje maksimale që këtë problem të zgjidhim një herë e mirë. Që nga viti 2017 jemi duke punuar në këtë drejtim, përkundër pengesave e edhe gjatë këtij viti kemi punuar e mjete janë paraparë edhe për vitin e ardhshëm.

Zenë Halilaj –administrator i fshatit Tërdec- projektet që janë në gjysmë gjatë vitit 2021 të hyjnë në projeksione për vitin 2022. Lagja Ramaj ka nevojë për asfaltim të kësaj rrugice. Ne ju jemi falënderues për projektet e kryera deri më tani, por kemi nevojë edhe për shumë projekte, sidomos asfaltimin e disa rrugicave në lagje si dhe të përfundohet edhe rrjeti i kanalizimit në të gjithë fshatin. Kemi nevojë po ashtu edhe për rregullimin e ndriçimit që të përfshihen të gjitha lagjet si dhe kemi nevojë edhe për rrjetin e ujësjellësit, por për këtë çështje mora përgjigje dhe shpresojmë që ky problem të zgjidhet vitin e ardhshëm.

Misin Leku, banorë i fshatit Baicë – ju falënderoj për të gjitha projektet e realizuara në fshatin tonë, ne kemi qenë në gjendje jo të mirë, por tani jemi shumë mirë me infrastrukturë, megjithatë kemi edhe disa kërkesë dhe sipas mundësive buxhetore, është mirë që të këtë ndriçim në të gjithë fshatin, sepse ndikon edhe në sigurinë e përgjithshme të Baicës.

Hartuesi i raportit :

Laureta Thaqi



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit të Komunës



Bashkësia Lokale e Tërstenikut (Tërstenik I dhe II, Vërboc, Polluzhë dhe Shtuticë) më datë. 19.08.2021, ora 13:45 në SHFMU “Zenel Hajdini” Tërstenik.



Mbledhjen e hapi Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, Bekim Dobra, duke filluar në ora 13:45, ku të pranishëm ishin: Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, Drejtori për Buxhet dhe Financa, Shyqiri Bublatku, Drejtori për Arsim, Muhamet Gjoka, Drejtori i Infrastrukturës Lokale, Endrit Gllareva, administratorë të vendbanimeve nga bashkësia e Tërstenikut dhe përfaqësues të lagjeve.

Fillimisht, Bekim Dobra i përshëndeti të gjithë administratorët e fshatit dhe qytetarët e pranishëm në takim, dhe shpalosi detajet e këtij takimi. Dobra ka njoftuar të pranishmit për rendin e ditës dhe ka treguar rregullat e takimit. Të pranishmit janë pajisur me draft-listën e investimeve kapitale për vendbanimin e tyre dhe janë njoftuar për buxhetin e ndarë për vitet në vazhdim. Po ashtu ata, janë njoftuar se dokumenti që kanë para vetës, është vetëm draft, sepse i njëjti ndryshon pikërisht në këto dëgjime me marrjen e kërkesave të arsyeshme nga qytetarët deri sa të merret vendim në mbledhjen e Kuvendit të Komunës para datës 30 shtator.

Rend dite:

1. Informatë e përgjithshme lidhur me buxhetin komunal 2022-2024.
2. Lista e investimeve kapitale në Bashkësinë e Terstenikut.
3. Kërkesat e banorëve.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci- ka përshëndetur takimin dhe ka treguar shkurtimisht për të arriturat deri më tani që i ka bërë komuna gjatë këtyre viteve dhe ka falënderuar të gjithë administratorët e vendbanimeve dhe përfaqësues të lagjeve për bashkëpunimin e treguar në realizimin e projekteve të përbashkëta për të mirën e qytetarëve.

Drejtori i Financave, Shyqiri Bublaku: Bublaku ka falënderuar të pranishmit që kanë gjetur kohën të jenë pjesë e këtyre dëgjimeve buxhetore dhe ka thënë se takimet e zhvendosura në lokalitete, kanë për qëllim që të hartojnë një buxhet sa më të mirë me projekte konkrete që dalin nga qytetarët të cilët marrin pjesë në këto takime. Bublaku ka thënë se këto dëgjime të mbajtura në muajin Gusht, kanë ardhur pas pranimin të Qarkorës së dytë buxhetore nga Ministria e Financave. Ai ka treguar para të pranishmeve edhe për mjetet buxhetore që ka planifikuar komuna t'i ndaj për vitet 2022-2024.

Kërkesat e qytetarëve;

Lulëzim Spahiu, banor i fshatit Tërstenik II – fshati jonë ka probleme me furnizimin me ujë të pijshëm, disa gypa janë vendosur në tokë, por ujë nuk kemi. Kam kërkesë që sa më shpejtë të kemi ujë të pijshëm, sepse po kemi edhe ikje nga fshati si pasojë që s'kemi ujë të pijshëm.

Avni Gjoka, banor i fshatit Tërstenik II – infrastruktura rrugore thuajë në fshatin tonë ka mbaruar, kanë mbetur vetëm disa rrugica të vogla pa u përfunduar, por me furnizim me ujë të pijshëm nuk kemi, prandaj kërkesa jonë kryesore për planifikimin e vitit të ardhshëm është të kemi furnizim me ujë të pijshëm.

Halim Mulaj, banor i fshatit Tërstenik II – në lagjen tonë janë 20 shtëpi banimi dhe para disa viteve janë vendosur gypat e ujit për pije, por nuk kemi, prandaj kërkesë e jona është sikur e parafolësve që fshati jonë për vitin e ardhshëm të ketë furnizim me ujë të pijshëm.

Kryetari Lladrovci – e kam sqaruar disa herë problemin me ujë të pijshëm edhe publikisht në media, por po e ndjej për obligim që të sqaroj edhe tani. Problemi për t'i furnizuar me ujë të pijshëm 22 fshatra, ish kryer qysh nga viti 2018, por siç e dini besoj, kur është bërë testimi i pompave në Kamenicë, gypat kryesor nuk ishin vendosur, projekt ky i realizuar në vitin 2013-2014 dhe për këtë çështje janë zhvilluar edhe hetime e për të mos u penguar hetimet, ishin stagnuar punimet. Tani janë vendosur gypat dhe projekti deri në Kamenicë është mirë, nëse nuk del telashe me gypat e vendosur në fshatra, projekti besoj që deri në gjysmën e dytë të vitit të ardhshëm do të kryhet ky projekt mjaft i rendësishëm dhe 22 fshatra do të kenë ujë të pijshëm.

Liridon Gjoka, banor i fshatit Tërstenik II – në lagjen tonë jemi 15 familje, që ne mungesë të ujit për pije, furnizohemi me puse private dhe janë të vendosur hidroforat në ato puse, e kemi pasur trafon e rrymës, por është shkëputur nga KEDS-i për mungesë të pagesës, prandaj kërkoj që kjo çështje të rregullohet, sepse ne kemi mbetur edhe nga pusët private pa ujë të pijshëm.

Kryetari Lladrovci – ajo çështje i përket KEDS-it, por ne do kërkojmë nga KEDS-i që të marrim më shumë informata dhe nëse është punë që kryhet, edhe do të kryhet gjatë këtij viti besoj.

Rexhep Istogu, administrator i fshatit Polluxhë- në fshatin tonë kërkesë është furnizimi me ujë të pijshëm, por edhe disa rrugica në lagje e po ashtu edhe trotuar rreth rrugës kryesore.

Fatmir Baliu, nga fshati Shtuticë – në fshatin tonë kemi nevojë që vitin e ardhshëm të kemi trotuarin kryesisht rrugës kryesore sepse kemi shumë nxënës që e frekuentojnë këtë rrugë dhe janë të rrezikuar nga makinat. Po ashtu kemi nevojë edhe ndriçim të lagjeve dhe rrugës kryesore.



Hartuesi i raportit:

Laureta Thaqi



Kryetari i Komunës

Bamir Lladrovci



Raport i dëgjimit buxhetor në bashkësinë lokale të Dobroshecit

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, neni 9 pika 2, Komuna e Drenasit harton Raport të Dëgjimit Buxhetor në Bashkësinë Lokale të Dobroshecit. Ky takim është mbajtur me datë 19.08.2021 në Bashkësinë lokale e Dobroshecit që përfshinë vendbanimet: Gradicë, Likoshan, Godan, Dobroshec, Gllanasellë dhe Çikatovë e Vjetër. Takimi ka filluar në ora 11:15 në shkollën “ShFMU Rilindja”. Në takim morën pjesë: Kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci, Drejtor të Drejtorive Komunale, Zyra e Informimit dhe përfaqësues të vendbanimeve.



Takimin e hapi Shefi i Zyrës për Komunikim me Publikun, Bekim Dobra dhe të pranishëm ishin: Kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci, drejtor të drejtorive komunale, përfaqësues të vendbanimeve e qytetarë.

Të pranishmëve, fillimisht i është shpërndarë materiali informues i linjave buxhetore dhe draft-lista e investimeve kapitale në vendbanimet e tyre. Gjithashtu, janë njoftuar se projektet për vitet e ardhshme nuk do të këtë vetëm nga draft-lista që kanë para vetës dhe propozimeve që ata japin, por edhe projektet të tjera nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Bekim Dobra: Para vetës keni një draft listë të projekteve që janë planifikuar për vitin e ardhshëm. Është një draft listë, dhe kjo bëhet finale pas takimeve me juve ku trajtohen kërkesat e juaja dhe miratohet në Kuvend.

Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës: Ju përsënder dhe falënderoj që jeni pjesëmarrës për qarkoren e dytë buxhetore për vitin 2020, pra për projektet që do të investohen në vendbanimet e juaja. Dy urat janë në proces ajo të Hajdaravit dhe Ademavit, ndërsa edhe rrugët të gjitha po përfundohen. Unë më shumë do ju jepi hapësirë juve që ta shqyrtoni këtë draft listë dhe kërkesat e juaja që i keni me prioritet t'i adresoni në mënyrë që ne t'i përfshijmë dhe që kjo listë të marr miratimin e fundit në Kuvendin Komunal.

Shyqiri Bublaku, Drejtor për Buxhet dhe Financa: Ju dëshiroj mirëseardhje. Ne fillimisht kemi pranuar qarkoren e dytë buxhetore cila përcakton kufijtë buxhetor. Nuk jemi të kënaqur me kufijtë buxhetor të caktuar nga niveli qendror, mirëpo ne duhet t'i zbatojmë. Shuma e buxhetit e caktuar për vitin 2022 është 15 milionë e 846 mijë 091 euro.

Bekim Dobra: Deri me 30 të këtij muaji keni mundësi që edhe përmes kërkesave dërguar administratorëve, të bëni ndryshime në këtë draft listë.

Eset Fejza, përfaqësues i lagjes në Dobroshec: Për ujësjellës, nuk na treguat ndonjë gjë. A pritet diçka lidhur me të? Gypat janë hi në Dobroshec nga arat e tona tek Carakt, gypa të zi deri në lagjen e Ademavit. Herën e dytë janë hi gypa të kaltër, janë mbetë vetëm mbi tokë. Me kanalizim, asfalt vërejtje nuk kemi.

Ramiz Lladrovci, kryetar i komunës: Ju e dini që qeverisja e kaluar e ka paguar projektin e gypave sikur e ka kryer e në fakt nuk i ka futur hiq. Tre vjet janë marr hetuesia me rastin derisa i kanë ngritur aktakuza personave përgjegjës. Pasi janë kryer hetimet, unë e kam zhvilluar projektin, e kemi dërguar ujin deri te bazenat e Kamenicës, e prej Kamenicës, po presim, po

mbajmë shpresë që do të lëshojmë ujin për Godanc, Likoshan, Gllanasellë e Dobroshec. Pra, ne i kemi përfunduar punët tona, pra i takon ujësjellësit. Ujësjellësi nuk na jep llogari neve, është përgjegjës që edhe nuk po i lëshon pompat e ujit prej Pokleikut, qashtu po bën probleme edhe prej kësaj ane. E dini që Godanc, Gllanasellë e vende tjera kanë ujë edhe kanë të vendosur orë, ujëmatës. Te ju gypat që janë jashtë, sigurisht nuk është kryer. Po pres që deri në fund të vitit të lëshohet uji në këto katune.

Abedin Caraku, Dobroshec: Kanalizimi nuk është kryer në lagjen tonë, rruga pa kry, ujësjellësi pa kry.....

Ramiz Lladrovci, kryetar i komunës: Ju e dini pse nuk u bë rruga, për shkak të unazës. Na kanë mbete ka 200 metra, ka 150 metra. Dritat i kemi vendos gjysmën e një fshati, gjysmën akoma. Disa i kanë vendosur vet. Aty ku kemi pasur mundësi i kemi vendos. Nuk ka qenë kërkesë e banorëve, por ne vetë kemi pasur mundësi dhe po e bëjmë për shkak se ofrojmë siguri më të madhe për banorët. Pra, për shkak të unazës ka mbetur.

Azem Avdyli, lagjja Avdyli: Kam vetëm një kërkesë, jo që su kry se kanalizimi është përfunduar, por, kanë dalë ujërat e zeza te Berisht dhe nën shtëpi tona. Problemin po e kam për shkak të bagëtive.

Ramiz Lladrovci: Ujërat e zeza kanë dalë për dy arsyeje, një e dini që vërshimet kanë bërë dëme. Kena pastaj defekte tjera se shportat e mbeturinave i kanë prish me qëllim, që me na bo problem ne fushatë që me humb vota se nuk po kryhet puna. Ne i kemi dërguar shportat e mbeturinave çdo familje dhe kemi nxjerr shumë buxhet për ta. Kompania i raporton nivelit qendror. Ujërat e zeza po ndikojnë se edhe po hidhen gjëra që nuk duhet, dhe po bllokohen pastaj gypat. Nuk mbyllen pa hedh diçka aty. Na njoftoni menjëherë, na intervenojmë përmes kompanisë. Na e kem obligim rrjetin kryesor, prej shtëpive e keni që me u kyç vet.

Hysen Avdyli nga fshati Likoshan: Si fshat kemi problem me kanalizim, përkatësisht me rrjetin e kanalizimit, ja dy vende e kemi mbyllur. Njëherë kanë ardh me intervenu po nuk kanë mundur me hapë, por na kanë thënë që duhet me ndrru komplet gypin. E për tjetrin gyp është shtypur nga firmat kur e kanë hap dhe prej aty po rrjedhin ujërat e zeza. Edhe disa metra të paasfaltuara kanë mbetur.

Ramiz Lladrovci: Janë kryer thuajse të gjitha e disa janë duke u kryer pra ende jemi duke punuar. Po pres deri në fund vitit që 99 përqind me u kry asfaltimi. Vetëm nëpër pronat nuk kemi drejtë, vetëm nëse i ktheni në emër të komunës. Përndryshe, në toka private nuk kemi drejtë sepse pastaj na padisin.

Qerim Berisha nga fshati Godanc: Sivjet po hyka rruga në projekt 250 metra nëse keni mundësi bile ne zhavorr se kompania pastrimi nuk po mundet as mbeturinat me i marr dimrit sepse terreni i papërshtatshëm për disa shtëpia tjera. Edhe ndriçimin nëse ka buxhet.

Ramiz Lladrovci: Qerim të gjitha janë në projekt, të planifikuara. Të gjitha do të përfundohen. Çdo vend ku janë shtyllat e betonit, do t'i vendosim. E di që ka pas hatër mbetje për shkak se disa vende janë vendos disa jo. Por, Drejtori i ka vendosur në disa pjesë e disa janë në proces. E po ka idhnime pse në disa pjesë fshatit po e disa jo. Mos u lidhni në rrjet pa na lajmërua sepse pastaj vijë dënimet nga KEDS për kyçe ilegale.



Hartusi i raportit

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Laureta Thaqi'.

Laureta Thaqi



Kryetari i Komunës

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Ramiz Lladrovci'.

Ramiz Lladrovci



Raport i dëgjimit buxhetor në bashkësinë lokale të Drenasit

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2018 për Standaret Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, neni 9 pika 2, Komuna e Drenasit harton Raport të Dëgjimit Buxhetor në Bashkësinë Lokale të Komoranit. Ky takim është mbajtur me datë 20.08.2021 në Bashkësinë lokale të Drenasit, që përfshinë vendbanimet: Drenas I, II dhe III, Pokleku i Ri dhe i Vjetër, Vasilevë, Gllobar dhe Shtrubullojë. Takimi ka filluar në ora 14:45 në shkollën ShFMU “Rasim Kiqina” në Drenas.



Takimi është zhvilluar me këtë rend dite:

- 1. Informatë e përgjithshme lidhur me buxhetin komunal 2022-2024*
- 2. Draft-Lista e investimeve kapitale sipas vendbanimeve ku mbahet takimi*
- 3. Kërkesat e banorëve*

Të pranishmëve u është shpërndarë materiali informues i linjave buxhetore dhe draft-lista e investimeve kapitale në vendbanimet e tyre. Gjithashtu, janë njoftuar se projektet për vitet e ardhshme nuk do të këtë vetëm nga draft-lista që kanë para vetës dhe propozimeve që ata japin, por edhe projektet të tjera nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun, Bekim Dobra: Para vetës keni një draft listë të projekteve që janë planifikuar për vitin e ardhshëm. Nuk është finale, është një draft listë, dhe kjo bëhet finale pas takimeve nëpër bashkësitë lokale, ku trajtohen kërkesat e juaja dhe miratohet në Kuvend. Prandaj, përmes këtij takimi adresoni kërkesat e juaja prioritare në mënyrë që të përfshihen në këtë draft buxhetim komunal.

Kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci: Ju falënderoj për kohën dhe pjesëmarrjen tuaj në këtë debat të rëndësishëm për buxhetin komunal. Takimi sotëm është diskutim për draft buxhetin apo draft listën e investimeve kapitale në vendbanimet që ju i përfaqësoni. Për detaje të projekteve dhe shumat e parapara do të ju njoftoj në vazhdim Drejtori për Buxhet dhe Financa.

Drejtori i DBF-së, Shyqiri Bublaku: Projektet që parashihen në këtë draft-buxhet për bashkësinë lokale të Drenasit janë Rregullimi dhe kultivimi i sipërfaqeve gjelbëruese dhe rregullimi i sheshit; Rehabilitimi i rrugëve të asfaltuara në Komunën e Drenasit; Sinjalizimi Vertikal dhe Horizontal i rrugëve dhe vendbanimeve; Rregullimi dhe rrethimi i varrezave në Komunën e Drenasit; Zgjerimi dhe mirëmbajtja e kamerave në komunën e Drenasit; Rregullimi dhe mirëmbajtja e trotuareve dhe parkingjeve; Instalimi i ndriçimit të ri dhe riparimi i rrjetit të ndriçimit publik ekzistues; Riparimi dhe zgjerimi i vendndaljeve për autobus dhe mbulimi i tyre. Bashkëfinancim projektsh si: Rregullimi i infrastrukturës, trotuareve dhe ndriçimit publik në Komunën e Drenasit; Ndërtimi i Infrastrukturës (Asfaltimi dhe kubëzimi) Drenas I, II, III dhe IV; Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit 'Fehmi Lladrovci'; Asfaltimi i rrugës në fshatin Pokleki Vjetër, i Ri dhe Vasilevë; Kanalizimi i ujërave të zeza dhe atmosferike në Drenasin I, II, III dhe IV.

Imri Bajraktari, përfaqësues i Drenasit III: “Ne si lagje jemi lagje e madhe, por investime nuk ka shumë”. Ai në vazhdim paraqiti disa kërkesa për kanalizim, disa rrugica të paasfaltuara, trotuare, ujë për Drenasin III. Paraqiti disa kërkesa për rrugën “*Rifat Kastrati*”, “*Mehmet Qorri*” “*Hysni Bilalli*” etj. Edhe për nxehjen qendrore çka ka ndodh, kur pritet ky projekt.

Ramiz Lladrovci: Të gjitha rrugët kryesore, publike janë kryer në Drenas I, II, III dhe IV. Kanë mbetur disa rrugica me nga 200-300 metra, por jo rrugët kryesore, të frekuentuara. Edhe për trotuare e rrugë, ku janë në prona private nuk kam mundësi. Sa i përket fasadës së bllokut social, është çështje e ministrisë dhe jo e komunës. Ndërsa, për nxehjen qendrore, termat e referencës janë bërë, jemi ndër 8 komunat që do të realizohet ky projekt, tani janë duke e bërë fizibilitetin.

Elmi Rexhepi: Kemi nevojë për trotuare. Kanalizimin e ke kry.... Urën të na, që është kryesore te Vermiq, pastaj edhe ndriçimin.

Ramiz Lladrovci: E kam paditë ministrinë për shkak se ka hapë gypin mes Çikatovës. Për ndriçim në disa pjesë, vendbanime ka përfunduar, në disa jemi në proces. Pra, të gjitha do të përfundojnë sipas projekteve që kemi në planifikim.

Liridon Sadiku, administrator i Drenasit I: Për vitin 2022 e pash që është projekti zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit, a mund të na jepni ndonjë të dhënë lidhur se si do të zhvillohet ky projekt.

Ramiz Lladrovci: Kemi pas me bo sivjet me bo, me hapë një tunel ose më mirë më thënë më mirë, me pre sheshin nga rruga që lidhet Xhevat Demaku e Ilaz Kodra deri të ish-shtëpia e mallrave, te Al Trade dhe në të dy anët me be parkingje. Të gjitha këto me mjete që i kemi fituar me punë të mirë, me performancë ku kemi zënë vendin e parë.

Bashkim Hamza, Shtrubullovë: Kryetar, kemi problem me kanalin te lumi se kur po ka vërshime po del mbi sipërfaqe tokës.

Ramiz Lladrovci: Për këtë çështje, ne i kemi bërë shkresë Ministrisë dhe e kemi paditë.

Jahir beqiri, Drenas II: Kanalizimin e keni kry, të falënderoj shumë. Keni kry punë, na kanë mbëtë edhe disa rrugica, 80 metra.

Zeka Kluna, Poklek i Vjetër: Në Poklek janë kry punë, por kam një kërkesë për vitin 2022. Ujin e thartë dhe me rregullu ndriçimin.

Ramiz Lladrovci: Për ujin e thartë, kemi vendosur mbulojën, po ka pas edhe plehra aty, kanalizim, dhe jemi duke e pastru. Edhe ndriçimi është në proces, për të gjitha vendbanimet në mënyrë që të ketë më shumë siguri.



Hartuesi i raportit

Laureta Thaqi

A blue circular official stamp of the Municipality of Poklek, Kosovo. The stamp contains the text 'KOMUNA E POKLEKUT', 'KOSOVA', and 'REPUBLIKA E KOSOVES'. Over the stamp is a handwritten signature in blue ink.

Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci



Raport i dëgjimit buxhetor në Bashkësinë Lokale të Arllatit

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2018 për Standaret Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, neni 9 pika 2, Komuna e Drenasit harton Raport të Dëgjimit Buxhetor në Bashkësinë Lokale të Arllatit. Ky takim është mbajtur me datë 20.08.2021 në Bashkësinë lokale e Arllat që përfshinë vendbanimet: Arllat, Llapushnik, Negroc, Vuçak dhe Gjergjicë. Takimi ka filluar në ora 10:15 në shkollën “ShFMU Abedin Bujupi”. Në takim morën pjesë: Kryetar i komunës, Ramiz Lladrovci, drejtor komunal, përfaqësues të vendbanimeve e qytetarë.



shty. Janë asfaltuar disa rrugë. Ka rrugë ende të paasfaltuara. Në lagjen Bujupi është bërë ndriçimi tash. Rrugës përgjatë autostradës nuk ka trotuare. Kemi kërkesë pse nuk jemi përfshirë në hartat zonale, pse ne jo e disa fshatra kanë hy. Na ujësjellës kemi në lagje, prej Ministrisë të Ambientit ka kushtuar 250 mijë euro investime, po veç me bë marrëveshje me ujësjellësin, por ka ngec, nuk është kry kjo punë. Lagjja e e Bujpve lartë është pa asfaltim, pa ujësjellës, veç me ndriçim kanë përfundu. Lagjen e xhamisë, përveç asfaltimit, tjetër investim s'ka. Ndriçim s'ka te këta e me trotuare e kanë keq, se nxënëset kalojnë andej. Lagjja e Foniqeve, e kanë kry kanalizimit brenda fshatit, po veç përtej fshatit ka mbet. Ndriçim nuk kanë, shtyllat i kanë. I kanë asfalt 70, 80 metra pa u asfaltu. Unë si administrator po i paraqesë në vija të trasha, e detajisht mund të flasin banorët.

Kryetar i komunës, Ramiz Lladrovci: Se pari për çështjen e mbeturinave, nuk është temë por dua të ju njoftoj se kjo është çështje e sabotazhit të shofereve që janë në këtë kompani. I kanë dëmtuar kamionët me qëllim që të mos mbledhin mbeturina. Tani po dalin me i heq edhe natën. Është kompani që i jep përgjegjësi tjetër nivel, rajonal dhe jo komunal. Në Llapushnik, kur i djegshin mbeturinat, ju i keni pa shenjat se është në vëzhgim të kamerave, të gjitha janë nën vëzhgim. Ujësjellësi e kemi dërguar para përgjegjësi, përkatësisht udhëheqësin e njësisë në Drenas. Ne nuk shpërndajmë ujin, por ne e vendosim rrjetin e mirëmbajmë. Kemi rast në Poklek të ri, kemi vendosur pompat, por nuk shkojnë me i lëshu. Rrjet të ujësjellësit pse nuk kanë fshatrat e tjera e dini tashmë, se keqbërësit kanë paguar projektin sikur është kryer, ndërsa në teren nuk është kryer fare. Janë zhvilluar për tri vite hetime, dhe përgjegjësit do të dalin para drejtësisë. Na i kemi vendosur pompat për të dërguar ujin në rezervarët e Kamenicës, por shefi i njësisë në Drenas ka thënë se nuk po mundemi me e dërgu uji nga Ferronikeli në Kamenicë me arsyetimin se nuk ka punëtor. Ne nuk mundemi ndryshe me i testu gypat apo përcjellët uji. Për hartat zonale, kanë qenë i hapur debati publik dhe para dy dite kam vendos me shty afatin e shqyrtimit, me shiku zonën edhe prej anës tuaj. Zonë ekonomike mundet me u be përgjatë rrugës kryesor kur nuk është në komasacion, dhe nuk ka me ndodh përderisa niveli qendror nuk e ndryshon ligji për komasacion. Për QKMF unë e kam ngritur zërin, por janë mjekët në specializim. As një komunë nuk e ka shërbimin 24 orë qysh e kemi ne. Për asfalt, ato që kanë mbetur 2500 metra dikund krejt pa u asfaltu, të gjitha do të kryhen me prioritet. Sa i përket ndriçimit është bërë gabim që psh gjysma e fshatit është vendosur ndriçimi e disa vende jo. Ka qenë gabim i drejtoratit, pasi është dashur komplet dhe jo me ndarje pasi po shkakton idhnime mes lagjeve. Ndriçimi është me rëndësi se ofron siguri për qytetarët.

Ramiz Lladrovci: Trotuari nuk ka qenë në projekt në Vuçak, sepse qarkullimi i veturave ka qenë i vogël, s'ka ndonjë lidhje me vende tjetra. Asfaltimi 250 metra sivjet i keni dhe sa i përket rrugës së Terdevcit, prej vitit të kaluar Ministria e ka tërhequr mbikëqyrësin, pa mbikëqyrës dhe miratimin e tij nuk mundemi me zhvillu. Kam qenë takim, me kanë premtuar që kanë me i caktu. Në rrjetin elektrik po punojmë, ne i kemi dhënë të gjitha lejet e mundshme, prandaj edhe është duke punuar.

Jeton Bujupi: Faleminderit për investimet deri me sot. Punët e mira që janë kryer deri sot nuk mundet me i mohu askush. Në pandemi ka pasur udhëheqje dhe menaxhim të mirë. Bujupi nga fshati Arllat paraqiti disa kërkesa si çerdhe dhe një teknik shëndetësor profesional për analiza në ambulanten në Arllat. Ai që ka qenë, ka shkuar në specializim.


Ramiz Lladrovci: Sa i përket punonjësit teknik shëndetësor për analiza të gjakut duhet me shiku bashkë me Drejtorin për Shëndetësi. Ndërsa për çerdhe, kur nuk ka personel e buxhet ne nuk mundemi me ndërtu çerdhe. Sepse, DKA-ja e ka të caktuar numrin e punonjës dhe nuk mund të rrisë këtë numër pasi nuk ka buxhet.



Hartuesi i raportit


Laureta Thaqi

Kryetari i Komunës



Ramiz Lladrovci



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Raport i dëgjimit të përgjithshëm buxhetor gjinor

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, neni 9 pika 2, Komuna e Drenasit harton Raport të Dëgjimit të Përgjithshëm buxhetor gjinor, i cili është mbajtur me datë 19.08.2021 në Sallën e Kuvendit Komunal. Në takim morën pjesë pjesëmarrës, ndërsa të pranishëm nga ekzekutivi i komunës ishin: Kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci, Shefi i Zyrës së Informimit, Bekim Dobra, UD Drejtor për Zhvillim Ekonomik, Laureta Thaqi, Drejtori për Buxhet dhe Financa, Shyqyri Bublaku, Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, Shqipe Zogu, Drejtoresha për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krapë. Në takim morën pjesë edhe Qendra për Promovimin e Drejtave të Grave, Këshilli i Veprimit Rinor Lokal e shoqata tjera të grave.



Dëgjimi i përgjithshëm buxhetor gjinor është mbajtur me këtë rend dite;

1. Informata të përgjithshëm lidhur me buxhetimin gjinor komunal 2022-2024;

2. Lista e investimeve gjinore;

3. Kërkesat e pjesëmarrëseve.

Kërkesat e adresuara	Nga:	Përgjigje
<i>Ndarja e buxhetit për grupe të marxhinalizuara përmes Zyrës për Barazi Gjinore</i>	<i>QPDG</i>	<i>Nuk ka kod të veçantë zyra për barazi gjinore, por të gjitha drejtoritë te subvencionet përfshijnë ndihëm ndaj grave të marginalizuara</i>
<i>Vendosja e rinisë në objekt</i>	<i>KVRL</i>	<i>Objekti rinor i është dhënë në shfrytëzim një organizate vendore sipas procedurave të Ligjit për dhënie e objekteve në shfrytëzim</i>
<i>Ndërtimi i çerdhes në Nekoc dhe përmes saj punësimi i grave</i>	<i>Dashurie Kastrati</i>	<i>Mjetet buxhetore pamundësojnë numrin shtesë të punonjësve në Drejtorinë e Arsimit. Jemi në proces të ndërtimit të katër çerdheve tjera.</i>

<i>Përkrahja e grave me subvencione</i>		<i>Përmes drejtorive, janë mbështetur gratë përmes thirrjeve të hapura për subvencione. Vlen të përmendet marrëveshja e kryetarit me AZHR-në për të ndihmuar gratë në agrikulturë. Po ashtu, edhe marrëveshja me HELP-in, ku në mesin e përfituesve kanë qenë edhe gratë.</i>
<i>Në mesin e administratoreve të ketë përfaqësuese grua</i>		<i>Zgjedhjet e këshillave lokale për caktimin e tyre kanë qenë të hapura, por interesimi i grave është tejet i vogël. Në vitin e ardhshëm u skadon mandati, dhe ne i inkurojmë të gjitha gratë që dëshirojnë të jenë administratore të vendbanimeve ku jetojnë të marrin pjesë.</i>

Këtë takim fillimisht e ka përshëndetur kryetari Lladrovci dhe ka treguar rëndësinë e këtij takimi për të informuar për buxhetimin gjinor dhe kërkesat e grave për tu përfshirë në këtë planifikim buxhetor.

“Po ndihem mirë kur po e shoh një pjesëmarrje kaq masive e juaj këtu, në këtë takim të rëndësishëm për buxhetimin gjinor. Në këtë takim ju do të keni mundësi të dëgjoni për buxhetimin gjinor komunal 2022-2021, investimet gjinore dhe të paraqisni kërkesat apo prioritet e juaja në mënyrë që të përfshihen në buxhetimin gjinor. Edhe njëherë ju faleminderit për pjesëmarrje dhe ju ftoj të jeni aktiv në paraqitjen e kërkesave të juaja”, ka thënë Lladrovci.

Ndërsa, Drejtori për Buxhet dhe Financa, Shyqyri Bublaku, të pranishmëve i ka dhënë informata të përgjithshme lidhur me ndarjen buxhetore që ka planifikuar komuna për buxhet gjinor si dhe listën e investimeve e cila iu është ndarë secilës pjesëmarrëse për të parë se cili është planifikimi në këtë drejtim.

Pas pikës së parë dhe të dytë ku më shumë ishin informuese, në pikën e tre, udhëheqësi i takimit, Bekim Dobra, kërkoi nga të pranishmit të paraqesin nëse kanë ndonjë kërkesë lidhur me ndarjen buxhetore gjinore.

Donika Zogu nga KVRL: Fillimisht do doja të falënderoj komunën për mbështetjen e rinisë, por asnjëherë nuk është mjaftueshëm. Shpresoj në vitet e ardhshme të behët më shumë në aspektin e fuqizimit të rinisë për përkrahje buxhetore. Na e dimë një organizatë është lincenu për objektin e qendrës rinore. A ka vlerë buxhetore ku gjatë këtij viti ose vitit të ardhshme, kur do të merret në shfrytëzim objekti dhe rinia të vendoset në zyre.

Shyqyri Bublaku, Drejtor për Buxhet dhe Financa: Sa i përket buxhetit nuk ka ndarje të veçantë, por ndahet në të gjitha kategoritë. Buxhet ku përfshihen të gjitha organizatat në fushën e rinisë, kulturës, sportit. Në DKR-së në vitin 2021, janë 125 mijë të planifikuar për mbulimin e ushtrimit të veprimtarive të shoqatave të tilla.

Kadire Tahiraj, Drejtoreshë e Qendrës për Promovimin e të Drejtave të Grave: Falënderoj kryetarin që na ka mbështetur fuqimisht në fuqizimin ekonomik të grupeve të marginalizuara.

A ka mundësi të këtë linjë buxhetore përmes Zyrës për Barazi Gjinore që të jenë përfituese gratë e grupeve të marginalizuara, që edhe të jenë fituese të granteve por edhe që ne të mund të aplikojmë për organizimin e kampanjave të ndryshme vetëdijësuese me aktivitete në Komunën e Drenasit.

Shyqyri Bublaku: Zyra e kryetarit përfshinë edhe buxhetin për ju. Është buxhet i limituar.

Tahiraj: Me vështirësi kemi shënuar fushatën e kancerit të gjirit, pastaj ditën e parandalimit të dhunës në familjes.

E autorizuar për Barazi Gjinore, Gentianë Morina: Nuk ka kod të veçantë për barazi gjinore, por në kuadër drejtorive tjera, përmes subvencioneve me ju ndihmu.

Dashurie Kastrati nga fshati Nekoc: Unë jam anëtare e shoqatës te Zonja Kadire. Kërkojmë përkrahje me shumë buxhet, në mënyrë që na të vetëpunësohemi. Kemi kërkesë edhe me bo çerdhe, me u punësu na vet, na mundemi me punu, me pas përkrahjen e juve. Ju falënderoj që na keni jep mundësi me i shpreh kërkesat tona në këtë takim.

Shyqyri Bublaku: Mundësitë buxhetore janë të limituara. I kuptojmë nevojat, po për çerdhe nuk kem mundësi për punësim se s'ka mbulim. Sepse numri i punonjëve në Drejtorinë e Arsimit është i plotësuar dhe nuk mundemi me rrit këtë numër. Këtë vit jemi në planifikim të ndërtimit të katër cerdheve, po nuk mundemi me shtu numër të të punësuarve. Nuk kemi buxhet me punësu.

Laureta Thaqi, UD Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik: Edhe ne si drejtorat kemi bashkëpunuar me QPDG ku kemi kërkuar të ju njoftojnë për një grant që është nënshkruar mes kryetarit dhe AZHR-së, i cili ka qenë për mbështetjen apo fuqizimin e grave në agrikulturë. Po ashtu, me organizatën HEPL janë ndihmar 40 ndërmarrës, në mesin e tyre edhe gra. Po ashtu, edhe me organizatën Women 4 Women janë mbajtur trajnime në kudoër të projektit për punësim dhe vetpunësim, k janë certifikuar mbi 30gra. Pra, ne kur ka thirrje tilla po ju informojmë përmes ueb faqës në mënyrë që të keni mundësi të aplikoni.

Kadire Tahraj: Në projektin e HELP-it përfituese kanë qenë edhe gratë e shoqatës tonë. Ne saherë ka thirrje, gjithmonë i njoftojmë grat e shoqatës e përmes tyre edhe gratë tjera. Kërkesë e jona është që në mesin e adminisratorëve të jetë femër. Sepse i dinë më mirë kërkesat dhe nevojat e tyre.

Bekim Dobra, Shefi i zyrës për Informim: Ne kemi pas thirrje publike për zgjedhjen e administratorëve të vendbanimeve, fatkeqësisht nuk ka pas interesim të grave. Një rast në Abri është

zgjedhur, por pastaj është tërhequr. Në vitin 2022 i skadon mandati, dhe në sërish do të nisim procedurat në bazë të ligjit, sepse vendbanimi i zgjedh e jo na.

Takimi ka përfunduar me këto kërkesa, për të cilat janë dhënë përgjigje nga ekzekutivi dhe janë mbajtur shënim nga procesmbajtjesja. Ky dokument protokollohet, u dërgohet drejtorive e zyrave përkatëse, dhe publikohet në ueb faqe.



Hartuesi i raportit


Laureta Thaqi



Kryetari i Komunës


Ramiz Lladrovci



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit



Raport i dëgjimit buxhetor në bashkësinë lokale të Komoranit

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2018 për Standaret Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, nën 9 pikë 2, Komuna e Drenasit harton Raport të Dëgjimit Buxhetor në Bashkësinë Lokale të Komoranit. Ky takim është mbajtur me datë 19.08.2021 në Bashkësinë lokale të Komoranit, që përfshinë vendbanimet: Kizhnarekë, Nekoc, Fushticë e Ulët dhe Epërme, Korroticë e Ulët dhe Epërme, Zabel i Ulët dhe i Epërm dhe Sankoc. Takimi ka filluar në ora 13:15 në shkollën ShFMU "Xhelandin Gashi-Plaku" në Komoran. Në takim morën pjesë: Kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci, Drejtor të Drejtorive Komunale dhe Zyrës së Informimit dhe përfaqësues të vendbanimeve.



Takimi është zhvilluar me këtë rend dite:

- 1. Informatë e përgjithshme lidhur me buxhetin komunal 2022-2024*
- 2. Draft-Lista e investimeve kapitale sipas vendbanimeve ku mbahet takimi*
- 3. Kërkesat e banorëve*

Të pranishmëve u është shpërndarë materiali informues i linjave buxhetore dhe draft-lista e investimeve kapitale në vendbanimet e tyre. Gjithashtu, janë njoftuar se projektet për vitet e ardhshme nuk do të këtë vetëm nga draft-lista që kanë para vetës dhe propozimeve që ata japin, por edhe projektet të tjera nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun, Bekim Dobra: Para vetës keni një draft listë të projekteve që janë planifikuar për vitin e ardhshëm. Është një draft listë, dhe kjo bëhet finale pas takimeve nëpër bashkësitë lokale, ku trajtohen kërkesat e juaja dhe miratohet në Kuvend. Prandaj, përmes këtij takimi adresoni kërkesat e juaja prioritare në mënyrë që të përfshihen në këtë draft buxhetim komunal.

Kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci: Ju faleminderit për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim ku do të diskutojmë për buxhetin komunal 2022-2024 si dhe draft listën e investimeve kapitale. Ne kemi arritur shumë projekte sipas planifikimit t'i përfundojmë. Investime infrastrukturore, ndriçim, kanalizim, ndërtimi i shkollës në Komoran, pastaj jemi duke punuar edhe në hartat zonale, ku kemi shtyrë afatin e shqyrtimit publik. Sot, do të keni mundësi të paraqitni kërkesat e juaja të cilat i vlerësoni të rëndësishme për vendbanimet që përfaqësoni dhe ne pastaj i inkorporojmë në buxhetin komunal për vitet 2022-2024. Por, keni mundësi t'i adresoni edhe përmes administratorëve të vendbanimeve të juaja në objektin e komunës së Drenasit, nëpër drejtoritë përkatëse.

Drejtori për Buxhet dhe Financa, Shyqiri Bublaku: Po ju paraqes projektet të cilat janë paraparë për bashkësinë lokale Komoran si: Rehabilitimi i rrugëve të asfaltuara në komunën e Drenasit; Sinjalizimi Vertikal dhe Horizontal i rrugëve dhe vendbanimeve; Rregullimi dhe rrethimi i varrezave në Komunën e Drenasit; Mirëmbajtja e kanalizimi fekale dhe atmosferike e gropave septike; Instalimi i ndriçimit të ri dhe riparimi i rrjetit të ndriçimit publik ekzistues; Zgjerimi dhe mirëmbajtja e kamerave në Komunën e Drenasit; Infrastruktura në Komoran I, II, III dhe IV; Ndërtimi i Infrastrukturës Nekoc e Kizhnarekë; Asfaltimi i rrugës në fshatin Sankoc, Fushticë e Epërme dhe Fushticë e Ulët; Kanalizimi i ujërave të zeza në Komoran I, II, III dhe IV; Kanalizimi i ujërave të zeza në Sankoc, Fushticë e Epermë dhe Fushticë e Ulët;

Kanalizimi i ujërave të zeza në Korroticë të Ulë, Epërme dhe Poklek të Vjetër e të Ri; Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Nekoc, Kizhnarekë.

Nexhmedin Gruda, Administrator i Komoranit II: Na kanë mbetur 250 metra gyp për ujërat e zeza në lagjen e xhamisë. Këtë kërkesë e kam adresuar në Drejtorinë për Infrastrukturë, dhe drejtori me ka thënë që do të përfundoj. Keq e kemi pjesën e kanalizimit të rruga 'Xheladin Gashi', janë dikund 600 metra, sepse është rrugë kryesore dhe ujërat e zeza kanë dalë mbi sipërfaqe. E kemi këtë kërkesë si më prioritare pasi është rrugë e frekuentuar dhe ka koga shtëpi. Rehabilitimi i rrugëve, është duke vazhduar. Po vazhdon pjesë derisa të përfundon. Për projektet për vitin 2021, një pjesë e ndriçimit, kanë mbet 600 metra dikund te rruga 'Pavarësia' te lagja Nishori.

Naim Krasniqi nga Komoran I: Ju përgëzoj për punën e mirë që keni bërë deri tani. Kemi kërkesë sfaltimin dhe rrugën nga Komorani te Parku, të pishat, dhe kisha një pyetje pasi keni shtyrë afatin e hartës zonal, a do të përfshihet Komorani te ndërtimet e larta.

Ramiz Lladrovci: Rruga do të behët, kanalizimi i ujërave të zeza e dini që po kemi problemi. Ne kemi vendosur gypa përgjatë gjithë lumenjve dhe përroskave, nuk kemi lejuar me u derdh, me i ndotë lumenjtë e sigurisht aq më pak nuk kemi dëshirë të derdhet nëpër oborre e ara të huaja. Pra, jemi në proces.

Sa i përket hartave zonale, ne kemi shtyrë afatin me qëllim që ju të adresoni kërkesat e juaja, për t'i përfshirë ato. Mundeni me ardh, është në shqyrtim dhe mund t'i jepni komentet, propozimet e juaja. Unë si kryetar, e kam ndalë ndërtimin e jashtëligjshëm.

Kadri Ajazi, Sankofc: Faleminderit kryetar. Këmi disa kërkesa, në lagjen Ramaj të behët rehabilitimi i kanalizimit. Po shpresoj që kryhen sivjet. Disa rrugë kanë mbet pa u asfaltu, rruga drejtim të varrezave etj.

Ramiz Lladrovci: Kanë mbetur disa rrugica pa u përfundu, por do të përfundojnë të gjitha. Nuk shtrojmë rrugë në drejtim të varrezave pa i kry të gjitha rrugët e fshatit, pastaj edhe atë do të përfundojmë.

Fahredin Hajdini, Zabel i Epërm: Faleminderit për punën kryetar, kam disa kërkesa, për ndriçim në disa lagje, varrezat, ujësjellës.

Ramiz Lladrovci: Varrezat juve Zabelit e Korroticës, ne kemi caktuar një sipërfaqe prej 1 hektar, është pronë e re dedikuar për varreza. Për kanalizim jemi në proces, nëpër ara. E dini që në rrug deri tash nuk na kanë leju. E për ujësjellës, tashmë të gjithë e dine që qeverisja e

kaluar ka paguar projektin prej bazenave të Ferronikelit e deri në Kamenicë, por kur kanë dalë terren me testu, kemi vrejtur që nuk është kryer fare projekti, edhe pse pagesa është bërë. Tri vite kanë marr kohë hetimet. Kam qenë të kryshefi i ujesjellesit në Prishtinë e kemi palarjmëru për padi për sabotazh dhe për mosdhenien e shërbimeve me ujë për qytetarët e Drenasit, se nuk po i lëshon pompat e ujit.

Për të gjitha kërkesat është mbajtur shënim dhe janë adresuar nepër drejtoritë përkatëse, drejtor të së cilave kanë qenë pjesëmarrës në këto takime buxhetore. I njëjti raport do të protokollohet dhe do të publikohet në ueb faqe në afat sipas Udhëzimit Administrativ Nr.06/2018 për Standaret Minimale të Konsultimit Publik në Komuna.



Hartuesi i raportit

Laureta Thaqi



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci